



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr/48 Datë 22/12/2008

**Mbi transferimin e fondit prej 1 000 000 Lek te alokuara per projektin
“Grante per biznese te reja” tek organizata bashkeimplementuese e
ketij projekti, CAAP (Aksione te Koordinuara Kunder Varferise)**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Marketingut dhe Turizmit “Mbi transferimin e fondit prej 1 000 000 Lek te alokuara per projektin “Grante per biznese te reja” tek organizata bashkeimplementuese e ketij projekti, CAAP (Aksione te Koordinuara Kunder Varferise)” si dhe ne zbatim te Ligjit nr. 8652 dt. 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” neni 32 pika dh. ligjin nr. 9836 dt. 26.11.2007 «Për buxhetin e Shtetit të vitit 2008 », Udhëzimin nr. 4 dt.17.01.08 i M.F «Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2008 », Udhëzimin nr 258 dt. 15.02.2008 i Ministrisë së Brendshme «Për zbatimin e buxhetit të qeverisjes vendore për vitin 2008», V.K.B nr. 12 dt. 18.03.2008 «Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2008», Ligji nr. 9936 dt. 26.06.2008 «Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë»

VENDOSI:

1. Te miratoje transferimin e fondit prej 1 000 000 Lek. i planifikuar ne Buxhetin e Bashkise per vitin 2008 ne llogarine bankare te organizates CAAP (Aksione te Koordinuara Kunder Varferise) me kete strukture buxhetore:

Pakesohet	00	01110	05	Art	6060000	- 1 000 000 Leke
Shtohet	00	01110	05	Art	6040000	+ 1 000 000 Leke

2. Te hartohet nje aktmareveshje me Bashkise dhe CAAP, ku do te percaktohen te drejtat dhe detyrimet e seciles pale.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Marketingut dhe Turizmit, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria Juridike

4. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETAR

Raimonda NASE